

Irena Hoxha



GJYQTARE E GJYKATËS SË TIRANËS


Deklaratat e analizuara:

14 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2004 deri Periodik/Vjetor 2016)

### Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2016

Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite



Pasuria bruto është rritur 18.5 herë.

+ 1,347,846 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.

### Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete në Cash

4,990,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Pasuritë e Luajtshme

500,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Pasuritë e Paluajtshme

13,032,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

### Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2016	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura paga nga funksioni	14,727,063	54.8%
Të ardhura paga e bashkëshortit	7,529,355	28.0%
Të ardhura nga qera (tokë dhe banese)	2,010,000	7.5%
Të ardhura të tjera	2,603,448	9.7%
<b>Total</b>	<b>26,869,866</b>	<b>100%</b>



### Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 13 vite rezultoi:

1 deklaratë Me Probleme  
12 deklarata Pa Probleme

Në vitin 2010, subjekti Irena Hoxha rezulton me burime financiare të pamjaftueshme në vlerë 2,410,020 lekë për të mbuluar shtesat e aseteve kursime në vlerën 1,200,000 lekë dhe apartament banimi në vlerë 12,032,000 lekë, pavarësisht huasë ndaj personave të tretë në vlerë 60,000 euro dhe të ardhurave vjetore të deklaruara.

Në vitin 2014, subjekti deklaron të ketë përfituar me trashëgimni 900 m2 tokë arë në Dibër, për të cilën nuk jepet vlerë aseti. Së bashku me 8,075 m2 sipërfaqe tokë truall dhe arë, të deklaruara në pronësi para fillimit të detyrës, jepen në përdorim duke gjeneruar të ardhura totale gjatë gjithë viteve të deklarimit në vlerë 1,710,000 lekë.

Me datë 31.12.2016 sipas deklarimeve subjekti rezulton me gjendje Cash progresive në vlerë 4,990,000 lekë, ndërkohë që sipas nenit 4/1 të ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, kufiri i lejuar për t' u mbajtur Cash është 1,500,000 lekë.

